



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 dhe 101.3 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Rregullën Zgjedhore nr. 09/2009 “Votimi dhe Numërimi brenda Vendvotimit në nivelin e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve” në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 07.09.2009 nxjerr këtë:

VENDIM

Për ndryshimin e procedurës së numërimit të Fletëvotimeve për Zgjedhjet Komunale të 15 nëntorit 2009

- I. Miratohet rekomandimi i Këshillit të Operacioneve Zgjedhore të KQZ-së i datës 04.09.2009 për ndryshimin e procedurës së numërimit të Fletëvotimeve për Zgjedhjet Komunale të 15 nëntorit 2009 si në vijim:
 - *Fletëvotimet për votim për Kryetar të Komunave do të numërohen të parat, përkatësisht para Fletëvotimeve për Kuvendet Komunale*
- II. Ndryshimi i procedurës së numërimit të Fletëvotimeve si në pikën I të këtij vendimi të përfshihet edhe në Doracakun e Trajnimit mbi Votimin dhe Numërimin.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me datë 07 shtator 2009.

Prishtinë, 07.09.2009

Nesrin Lushta

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve